

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	 PRISHTINA
---	--	---

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

NITI - N SH.P.K., me adresë: ULPIANA A1-LOK-2A, -, PRISHTINË, Kosovë, me nr. të regjistrimit të biznesit: 810839300, me numër të certifikatës fiskale: 810839300, me drejtore: Naim Zymeri (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës për institucionet arsimore

me numër identifikues:

Nr i brendshëm	616 20 050 221
----------------	-----------------------

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës për institucionet arsimore

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontratë publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e sherbimeve që duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sositë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendor në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me **14.07.2020** dhe përfundon në datën **14.07.2021**

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë **12 muaj** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Institucionet Arsimore në Komunë të Prishtinës

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofreesi i Shërbimeve.

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **70.000,00 €; [Shtatëdhjetë mijë]** Euro. Çmim njësi i ofertës është: **87,70 € (Tetëdhjetë e shtatë euro dhe shtatëdhjetë cent)**. Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative e njësisë është [+30%].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofreesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fiksë dhe nuk do ti nënshtronen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofreesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *[Ishëno çdo dispozitë tjeter të dosjes së tenderit].*

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofreesit të Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvçe nëse specifikohet ndryshtësia në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndjonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet **[Angleze] [Shqipe] [Serbe]¹** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofreesin e Shërbimeve.

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Zekë Bardhaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	



Për Ofroesin e Shërbimeve

Emri:	Naim Zaimi
Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:	
Data:	16.07.2020
Vula:	



PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Shërbimet**" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "**Ofrues i shërbimeve**" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "**Personeli**" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "**Çmimi i kontratës**" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "**Nënkontraktuesi**" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "**Palë**" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "**Palët**" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "**Autoriteti Kontraktues**" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "**KPK**" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "**KVK**" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënes së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënen e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontrakton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëron nga këto arsyë:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèçse kur është rënë dakord ndryshtë ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitet, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjeter e ngashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofrofuesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjeter i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjeter, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofrofuesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofrofuesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjetë të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofrofuesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofrofuesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofrofuesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofrofuesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofrofuesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofrofuesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofrofuesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofrofuesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupcion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofrofuesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofrofuesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe

Ofruesit tē Sherbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund tē nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë tē tretë nē emër tē Ofruesit tē Sherbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit tē njoftimit tē ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Sherbimeve që tē ndërmarrë hapa tē menjëhershëm pér ta përbyllur ekzekutimin e sherbimeve nē mënyrë tē shpejtë dhe tē rregullt dhe pér t'i zvogëluar nē minimum shpenzimet.

9.4 Në rast tē ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që tē jetë e mundur dhe nē prani tē Ofruesit tē Sherbimeve ose tē përfaqësuesve tē tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi sherbimet e kryera. Do tē përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit tē Sherbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Sherbimeve Autoritetit kontraktues nē datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do tē jetë i obliguar tē bëjë pagesa tjera pér Ofruesin e Sherbimeve derisa tē jenë përfunduar sherbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do tē ketë tē drejtë tē marrë nga Ofruesi i Sherbimeve koston ekstra, nëse ka, pér tē siguruar ofruesin e sherbimeve ose do tē paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit tē Sherbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpresë kontratën, ai do tē ketë tē drejtë tē marrë nga Ofruesi i Sherbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Sherbimeve

10.1 Ofruesi i Sherbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit tē Sherbimeve shumat që duhet tē paguhen nē ndonjë certifikatë tē lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit tē afatit tē fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve tē përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Sherbimeve është i paaftë tē kryej një pjesë materiale të Sherbimeve pér një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do tē bëhet pa paragjykim pér ndonjë tē drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit tē Sherbimeve.

10.3 Në rast tē ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Sherbimeve pér humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit tē Sherbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit tē Sherbimeve

11.1 Ofertuesi do tē kryejë Sherbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, nē përputhje me praktikat më tē mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Sherbimeve duhet tē pajtohet me urdhërat administrative tē dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i sherbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përej fushëveprimit tē kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit pér shkelje tē kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues pér këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit tē urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do tē pezullohet pér shkak tē këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Sherbimeve duhet t'i respektojë dhe tē veprojë sipas tē gjitha ligjeve dhe rregulloreve nē fuqi nē Republikën e Kosovës dhe do tē sigurojë që personeli i tij, tē afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë tē tij gjithashtu t'i respektojnë dhe tē veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Sherbimeve do tē trajtojë tē gjitha dokumentet dhe informacionet e marra nē lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do tē shpëtojë pér aq kohë sa tē jetë e nevojshme pér qëllimet e ekzekutimit tē kontratës, tē batojë ose tē zbulojë ndonjë tē dhënë tē kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim tē Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i sherbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, tē gjithë personat ose korporatat e tillë do tē jenë së bashku dhe veçmas tē detyruar pér tē përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi pér tē vepruar nē emër tē tij pér qëllimet e kësaj kontrate do tē ketë autoritetin pér tē lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do tē ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim tē Autoritetit

Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitetë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 **Obigimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj “Menaxherin e Projektit”, i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 **Dëmet e Likuiduara**

13.1 Nëse Ofruesi i sherbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së sherbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit sherbime parandalon përdorimin e zakonshëm të sherbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Sherbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënen e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofruesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofroes i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofroesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofroesi i sherbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofroesit të Sherbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofroesi i Shërbimit

15.1 Ofroesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofroesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofroesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofroesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjetet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofroesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofroesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofroesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofroesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- dëmet; dhe/apo
- ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- dëme të përgjithshme; ose
- dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kérkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kérkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kérkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpérblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpérblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA)
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së përgjithshme të kontratën në vlerë prej: 7.000,00 € (Shtatëmijë euro) në vlefshmëri prej: 13muajsh
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Polisa e sigurimit për përgjegjësinë ndaj palëve te treta lëshuar nga një kompani e licencuar dhe e njohur e sigurimeve, (Polisa duhet te ketë vlerën se paku një mijë euro (1000 €))
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: <i>[shëno]</i> Periudha e përgjegjësise së Defekteve është I vit garacion
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherëshëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**MIRËMBAJTJA E ELEKTRIKËS DHE SERVISIMI I GJENERATOREVE NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PËR VITIN 2020**

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

	Nr	Pershkrimi i puneve	Njesia	Sasia	Pesha (%)	Çmimi
Mirëmbajtja e elektrikës						
Instalimi i rrymave te forta						
Grupi I -re (55%)	1	Porosia furnizimi dhe montimi i Panelit ndricues LED 45W me fluks 3600 lm dhe dimensione 60cmx60cm , per montim ne amstrong apo plafon	copë	1	55%	18
	2	Porosia, furnizimi dhe montimi i panelit ndricues LED 45W me fluks 3600 lm dhe me dimensione 120cmx30cm per montim ne plafon	cope	1		13
	3	Porosia, furnizimi dhe montimi i panelit ndricues LED 20W per montim ne banjo	cope	1		1
Grupi II-te (5%)	4	Porosia dhe montimi i tubit fluroshent 1x36W.	cope	1	5%	0.1
	5	Porosia dhe montimi i tubit fluroshent 1x18W.	copë	1		0.1
	6	Porosia dhe montimi i shuares (trafos) Mekanike 20-40	copë	1		0.1
	7	Porosia dhe montimi i shuarses (trafos) Elektronike20-40	copë	1		0.1
	8	Porosia dhe montimi i starterave për panele me qypa floroshent	copë	1		0.1
	9	Porosia furnizimi dhe montimi i poqave led 10W	copë	1		0.1
	10	Porosia, furnizimi dhe montimi i poqave ekonomike 60W	cope	1		1
	11	Porosia furnizimi dhe montimi i fytave E27 per poqa ekonomik	copë	1		1
Grupi i III-te (10%)	12	Porosia, dhe montimi i reflektorëve LED 50W me fluks te ndricimit 4000-4500 lm (ne cmim te parashihen edhe skelet per montim te reflektoreve ne lartesi deri ne 10m)	cope	1	10%	1
	13	Porosia , furnizimi dhe montimi i reflektoreve LED 100W me fluks te ndricimit 8000 lm (ne cmim te parashihen edhe skelet per montim te reflektoreve ne lartesi deri ne 10m)	cope	1		1

	14	Porosia, furnizimi dhe montimi i prizes njefazore njëshe dhe dyshe te vendosura ne mure me kuti komplet Ø60 Llogaritja me qmim mesatar	copë	1		
	15	Porosia, furnizimi dhe montimi i Prizes trifazore komplet me materialin e nevojshem per montim te prizes	copë	1		3
	16	Porosia, furnizimi dhe montimi i Prizes OG te jashtme	copë	1		3
	17	Porosia, furnizimi dhe montimi i Prizes modularare njefazore te vendosura ne kuti te tokes.	copë	1		2
	18	Porosia, furnizimi dhe montimi i Nderpresve serik te thjesht, alternativ me kuti te (e kompetuar)	copë	1		0.5
	19	Hapja e kanalit me dimensione 0.4mx0.8m per vendosjen e kabllove furnizuese te objektit te shkollave duke perfshire gypin e brinjezuar pvc Ø70mm	m	1		3
Grupi IV-te (15%)	20	Furnizimi dhe vodosja e kabllos furnizuese PP-Y 4x25mm ² (Al)+ PF 1X25mm ² komplet me papuhe , gyp te brinjezuar Ø50mm dhe materiali tjeter I nevojshem	m	1		0.1
	21	Furnizimi dhe vodosja e kabllos furnizuese PP-Y 4x16mm ² (Al)+ PF 1X16mm ² komplet me papuhe , gyp te brinjezuar Ø50mm dhe materiali tjeter I nevojshem	m	1		0.1
	22	Furnizimi dhe vodosja e kabllos furnizuese PP-Y 4x4mm ² (Cu) mm ² dhe futja e saj ne gyp te brinjezuar .	m	1		0.1
	23	Porosia furnizimi me material dhe punimi i qarkut rrymor te drites me kabillo PP00 3x1.5mm ² Cu, duke perfshire komplet materialin e imet te nevojshem	m	1		15%
	24	Porosia, furnizimi dhe montimi I kabllove PP00 3x2.5mm ² Cu per furnizim e prizave njefazore , 380V	m	1		3
	25	Porosia dhe montimi I kabllit PP00 5x2.5mm ² Cu per furnizimin e prizave trefazore	m	1		3
	26	Furnizimi dhe vodosja e gypave të brinjëzuar vetëshues.Ø22	m	1		0.1
						0.1

27	Furnizimi dhe montimi I kanaletave te plastikes per montim te kabllove ne mure	m	1	0.1
28	Porosia dhe montimi I tabelave shperndarese nga plastika me dy rende per siguresa	cope	1	0.1
29	Porosia dhe vodosja e ormanit kryesor shpërndarës dimesione (80X40)cm , ormani është i punuar nga llamarina dy herë e dekapiruar dhe me elzet-çelës.	copë	1	1
30	Porosia dhe vodosja e ormanit kryesor shpërndarës dimesione (120x100)cm, ormani është i punuar nga llamarina dy herë e dekapiruar dhe me elzet-çelës.	copë	1	1
31	Porosia, furnizimi dhe montimi Siguresave L10A, L16A, L20A, L25A, L32A. Te prodhesit Shnieder ose te ngjajshme. Llogaritja me cmim mesatar	cope	1	3
32	Porosia, furnizimi dhe montimi i Kontaktorit CN-16A-40A.Llogaritja me cmim mesatar	copë	1	0.5
33	Porosia, furnizimi dhe montimi I kontaktorit CN -63A	copë	1	0.5
34	Porosia dhe montimi I kontaktorit CN-160A	cope	1	0.5
35	Porosia, furnizimi dhe montimi I kontaktorit CN -250A	cope	1	1
36	Porosia, furnizimi dhe montimi I Kontaktorit CN-500A	copë	1	2
37	Porosia, furnizimi dhe montimi i "FID"-nderpresi 40/0.03A, 60/0.03A	copë	1	1
38	Porosia furnizimi dhe montimi i Siguresave thikore 63A.Llogaritja me cmim mesatar	copë	1	0.5
39	Porosia, furnizimi dhe montimi I nderpreresisit AS 40 A	cope	1	0.5
40	Porosia furnizimi dhe montimi I nderpreresisit AS 63A	cope	1	0.5
41	Porosia furnizimi dhe montimi I nderpreresisit AS 100A-300A	cope	1	1
42	Porosia furnizimi dhe montimi I nderpreresisit AS 400A-630A	cope	1	1

Grupi V-të (2%)	43	Porosia furnizimi dhe montimi i nderpresit te fuqisë tipit DPX 63A-300A me mbrojtje nga lidhjet e shkurta dhe mbingarkesa (7-10)In, gjegjisht (0.7-1)In. Nderpresi duhet te kete aftesi qkyqese $I_{ck}=50kA$	copë	1		0.5
	44	Porosia furnizimi dhe montimi i Shkarkuesit të mbitensionit 4xPK0.38/0.5	copë	1		0.5
	45	Porosia, furnizimi dhe montimi i Materialit te imet per tabele: kleme, papuhe, borno,perques, shina bakri per montim te siguresave, PVC lidhse etj. Material i imet percjells per kablla: Gips gozhda shirit I vrimezuar etj..	copë	1		0.5
	46	Porosia,furnizimi dhe vendosja e shiritit të zinguar Fe /Zn25x4mm me të gjitha materialet shtesë	m	1		0.5
	47	Porosia, furnizimi dhe vendosja e shiritit të zinguar Fe/Zn20x3mm në pjesën e kulmit.Të gjitha daljet prej themelit të punohen me të njëjtin shirit,kurse lidhjet të bëhenme paisje kryqëzuese .Ketu hyjne edhe rrufekapesit dhe 4 kuadrot testuese.	m	1		0.5
	48	Porosia,furnizimi dhe lidhje e paisjeve kryqëzuese	copë	1		0.1
	49	Sondespërtokëzuese Ø75mm/3000mm,e cila futet në gropën e hapur më parë e pastaj pas futjes së gypit ,gropa mbushet me dhe të ngjeshur .Sondat përmes lidhëseve(paisjeve kryqëzuese) të lidhen me përtokëzuesin-shirit të themelit.	copë	1	2%	0.5
	50	Porosia e realizimit te protokollit te matjes se përtokëzimit (atestet e tokezimit)dhe shqyrtimi i punëve të kryera për instalimin e përtokëzimit mbrojtës nga kompani e licencuar per matje .Çmimi jepet paushall.Ky pozicion për 1 copë vlen për 1 shkollë (objekt)	copë	1		0.5
Instalimi i rrymave te dobëta						
Grupi I V-të	1	Porosia, furnizimi dhe montimi I prizes se internetit	cope	1	3%	0.1

	2	Porosia,furnizimi dhe montimi i Dritave emergjente	copë	1		0.1
	3	Porosia,furnizimi dhe montimi i Utpcable	m	1		0.1
Servisimi i gjeneratorëve ne shkolla						
Grupi VII-të (10%)	1	Furnizimi me vaj Motorri per gjenerator	I	1		2
	2	Furnizimi dhe montimi i filterit te ajrit	cope	1		3
	3	Furnizimi dhe montimi i filterit te naftes	cope	1		2
	4	Furnizimi dhe montimi i filterit te vajit	cope	1		2
	5	Furnizimi dhe montimi i baterisë per gjenerator	cope	1		3
	6	Furnizimi dhe montimi i papuqes Cu 50mm	cope	1		0.5
	7	Furnizimi dhe montimi i ventilit jokthyes	cope	1		1
Gjithsejt :					100%	87.7
TOTALI:				87.70 €		